



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1158/1 Prot.

Tiranë, më 03.08.2021

V E N D I M

Nr. 140, Datë 03.08.2021

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 09, datë 10.02.2021, të paraqitur nga E.M kundër Bashkisë Mat dhe Sektorit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi, në të cilën pretendohet për diskriminim për “çdo shkak tjetër¹”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, subjekti ankuesi në mes të tjerash informon se: “Me Vendimin nr. 36, datë 30.01.2018 të Shefit të Sektorit të MZSH të Bashkisë Mat është emëruar në pozicionin e “Zjarrfikësit dhe shpëtuesit”. Me Urdhërin nr. 486, datë 14.07.2020 i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës me arsyetimin se është marrë në punë në kundërshtim me kriteret e pranimit, pasi nuk ka përfunduar testimin fiziko-profesional dhe kursin përkatës pranë Akademisë së Sigurisë. Ankuesi informon se, si rasti i tij kanë qenë të pa trajnuar dhe punonjës të tjerë si, A.K dhe G.S. Shtetasi A.K ka vijuar të kryejë detyrën e “Zjarrfikësit” edhe përgjatë gjithë periudhës që atyre i ishte ndërprerë marrëdhënia e punës, e cila verifikohet në “Librin e marrjes dhe dorëzimit të detyrës”, që ndodhet në Sektorin e MZSH-së Mat. Ankuesi informon se pas largimit të tij, janë marrë në punë të gjithë ato persona që kanë qenë në kushtet e tija, pasi ata kanë vijuar marrëdhëniet e punës dhe në kohën që kishte filluar procedura e largimit. Ankuesi shpjegon se është larguar nga detyra për arsye politike, pasi më përpara se të fillonte punë pranë MZSH Mat, ka qenë anëtar i PD-së dhe familja e tij ka bindje të djathta”.

¹ Për shkak se përpara se të fillonte punë ka qenë i anëtar i subjektit politik, Partia Demokratike e Shqipërisë, por është larguar nga ky subjekt, kur është emëruar zjarrfikës dhe shpëtues, pasi e kishte të ndaluar me ligj. Referuar Vërtetimit nr. 63, datë 14.12.2020 të Partisë Demokratike, Dega Mat, E.M ka qenë anëtar nga viti 2017.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe rimarrjen në detyrën e mëparshme si zjarrfikës, pranë MZSH Mat.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Neni 7/1 i LMD-së², parashikon se: *“Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash, përbën diskriminim”.*

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit, të ndryshuar, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Duke qenë se shpjegimet dhe dokumentacioni i dhënë nga ankuesi, në ankesën e bërë pranë zyrës së Komisionerit ishin të paqarta, institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me e-mail-in datë 15.02.2021 dhe shkresën nr. 286/1, datë 19.02.2021, kërkoj nga ankuesi informacion dhe dokumentacion shtesë.

Subjekti ankues me e-mail-in, datë 01.03.2021 ka dërguar pranë Komisionerit, kopje të kërkesë padisë, vendimit të gjykatës dhe të kundërshtimit në apel, lidhur me procesin gjyqësor të ndjekur nga ana e tij për largim të padrejtë nga puna.

Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 09, datë 10.02.2021, të paraqitur nga E.M u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit

² Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të ndryshuar.

10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- Me shkresën nr. 286/2, datë 04.03.2021, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar informacion dhe dokumentacion nga, Bashkia Mat për ankesën e bërë nga E.M.

Me shkresën nr. 1091/1, datë 26.03.2021, Bashkia Mat dërgoi dokumentacionin e kërkuar dhe në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“Urdhëri nr. 486, datë 14.07.2020 “Për ndërprerje të marrëdhënieve të punës” me E.M është nxjerrë nga Shefi i Sektorit të MZSH-së pranë Bashkisë Mat dhe kjo është pasqyruar tek baza ligjore e aktit. Pra, nuk ka si të pretendohet se akti është nxjerrë nga Kryetari i Bashkisë, pasi mbi të gjitha askund në dispozitat ligjore ku është referuar Shefi i Sektorit të MZSH-së dhe grupi i punës për hartimin e aktit, në asnjë rast nuk është cituar kompetenca e Kryetarit të Bashkisë për të ndërmarrë një veprim të tillë. Nënshkrimi i Kryetarit në akt është thjeshtë miratues me karakter formal të veprimeve të Përgjegjësit të Sektorit të MZSH-së në cilësinë e eprorit dhe nuk ka asnjë ndikim me karakter ligjor. Sqarimet e mësipërme janë në një linjë me gjetjet e organit gjyqësor që ka shqyrtuar padinë e ankuesit, dhe konkretisht Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, në Vendimin nr. 3199, datë 04.12.2020 ka rrëzuar të gjitha pretendimet e E.M. Lidhur me pretendimin, se në të njëjtën pozitë si ankuesi, kanë qenë të patrajnuar dhe punonjësit e tjerë të MZSH-së Mat, si ato të nivelit bazë dhe ato të nivelit të mesëm, sqarohet se pranë Sektorit të MZSH-së nuk ka të punësuar asnjë punonjës të nivelit të mesëm. Referimi vetëm në emrat e punonjësve A.K dhe G.S është jo korrekt, pasi procedura e largimit të punonjësve të Sektorit të MZSH-së, për të cilët është konstatuar se rekrutimi është bërë pa konkurrim, nuk përfshin vetëm personat e cituar më sipër, por edhe punonjës të A.M. Lidhur me pretendimin se shtetasi A.K ka vijuar detyrën e “Zjarrëfikësit” edhe gjatë periudhës që ishte ndërprerë marrëdhënia e punës, sqarohet se afatet e largimit nga puna janë të ndryshëm për punëmarrës të ndryshëm në varësi të vjetërsisë në punë. Punonjësi A.K ka filluar punë në Sektorin e MZSH-së para punonjësve të tjerë të përmendur në procedurë, kështu që dhe afati ligjor i largimit nga detyra, duke qenë se është ndjekur e njëjta procedurë, ka qenë e ndryshme, d.m.th. ka patur periudhën e afatit të njoftimit më të gjatë në kohë. Lidhur me pretendimin se E.M është trajtuar në mënyrë të pabarabartë dhe të disfavorshme, bashkia sqaron se, bazuar në faktet shkresore, vërtetohet se të katër punonjësit e Sektorit të MZSH-së, G.S, A.M, E.M dhe A.K, të rekrutuar jo në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, duke u gjetur në kushte paligjshmërie të marrëdhënieve të tyre të punës janë larguar që të katër nga puna me procedurë normale ligjore. Lidhur me pretendimin e ankuesit se ai paska qenë në të shkuarën anëtar i Partisë Demokratike, rezulton se në lidhje me pjesën që po analizojmë, të mos jetë i bazuar në fakte dhe prova bindëse. Në asnjë rast nuk provohet, që ankuesi para se të fillonte punë të ketë qenë anëtarë i PD-së. Duke analizuar rregullimin statutor të procedurës së anëtarësimit dhe përfundimit të anëtarësisë në PD, ankuesi nuk arrin të provojë me fakte të ligjshme, se ai para se të fillonte punë në Sektorin e MZSH-së, të ketë qenë anëtar i PD-së, pasi sipas statutit të*

PD-së duhet të kishte bërë një kërkesë me shkrim, të kishte plotësuar formularin e anëtarësimit, të ishte pajisur me kartë anëtarësie, si dhe të ketë ushtruar detyra me karakter politik që të provonin pretendimin e tij si anëtar aktiv i kësaj force politike. Gjithashtu ankuesi nuk ka arritur të provojë faktin se ka dhënë dorëheqjen nga anëtarësia e PD-së në momentin që ka filluar punë pranë MZSH-së, pasi ishte e ndaluar për shkak të funksionit. Duke parë këtë rast në tërësinë e fakteve dhe provave, nuk krijohet bindja që ankuesi të ketë qenë një person, ku të provohet se ka bindje politike të njërit apo tjetrit krah politik, si dhe ku ai të jetë njohur publikisht për këtë gjë. E njëjta gjë vlen edhe për familjen e tij, duke qenë se ai pretendon se familja e tij ka bindje të djathta. Bashkia Mat me të njëjtën procedurë që ka larguar E.M që e zëmë ka pasur bindje të djathta, ka larguar dhe punonjës të zjarrfikës A.M, i cili ka qenë anëtar i Partisë Socialiste, po ashtu dhe pjesëtarët e familjes së tij, fakt i cili pranohet nga vetë punonjësi. Lidhur me pretendimin se Bashkia kishte detyrimin ligjor dhe njerëzor për ta njoftuar në lidhje me testimet dhe trajnimet që do të zhvilloheshin, theksojmë se procedura e trajnimit nuk zhvillohet apriori. Procedurat janë publike dhe të hapura për të gjithë dhe nuk mund të bëhen ad personam, (në nenin 40 të VKM-së nr. 520, datë 25.7.2019 “Për miratimin e rregullores për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin” parashikohet: “Njoftimi për kriteret, kohën, rregullat dhe procedurën e aplikimit realizohet nëpërmjet njoftimeve në mediat vizive të shkruara lokale ose njoftimeve në faqen zyrtare të bashkisë”. Procedura e konkurrit ë shtë bërë publike dhe e hapur, dhe vazhdon të bëhet e tillë, kemi të paktën dy raste të tilla procedurash në vitin 2020 dhe një në vijim në vitin 2021. A mund të thotë ankuesi se kush e ka penguar të paraqesë dokumentet për konkurrim. Ndërkohë do të kërkonim, që ankuesi të provonte se në çfarë mënyre bashkia e ka trajtuar ndryshe me A.K, aq më tepër se ai dhe familja e tij janë të njohur më shumë sesa familja e ankuesit për bindje të djathta dhe si mbështetës të PD-së?! Llogjika e ankuesit bën të kuptosh, që janë larguar dhe nuk mund të rekrutohen ata që paskan bindje të djathta, atëherë kjo nënkupton që duheshin larguar të “djathtët” (ankuesin dhe A.K, i cili është rekrutuar sërish më vonë me procedurë të rregullt) dhe jo të “majtët” (A.M), por e vërteta është, se janë larguar që të gjithë punonjësit e gjetur në marrëdhënie pune të lindur në kushtet e paligjshmërisë. Bashkia thekson se janë larguar dhe tre punonjës të tjerë që kanë qenë në të njëjtën pozitë paligjshmërie në marrëdhëniet e punës si ankuesi: A.K, datë 23.07.2020, E.M, datë 14.07.2020, A.M, datë 23.06.2020 dhe G.S, datë 11.06.2020. Në lidhje me dosjen e punonjësit D.U, të pretenduar nga ankuesi, se qënka marrë në punë pranë MZSH-së, ju bëjmë me dije se nuk ka asnjë shtetas me emrin D.U që të jetë marrë në punë nga Sektori i MZSH-së. Çështja është ndjekur gjyqësisht dhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me Vendimin nr. 3199, datë 04.12.2020, ka vendosur rrëzimin e kërkesë padisë së ankuesit E.M, duke e konsideruar të ligjshme procedurën e ndjekur nga Bashkia Mat për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës të ankuesit”.

Në përgjigje të shkresës së Bashkisë Mat, subjekti ankues me e-mail-in datë 06.04.2021, në mes të tjerash ka informuar Komisionerin se: “E gjithë procedura për lirim nga detyra të: E.M, G.S, A. K dhe A. M është kryer nga Kryetari i Bashkisë pasi këtë e tregojnë shkresat zyrtare dhe

procedura e ndjekur, pra nuk janë kryer nga shefi i sektorit, thjeshtë në fund të urdhërit është firmosur nga ai. Ankuesi thekson se nuk ka asgjë me shefin e sektorit, por a është i njëjti person që ka qenë shef sektori dhe në kohën kur është marrë ai në punë. Bashkia Mat në arsyetimin e saj, kur i referohet Vendimit 30/2021 të KMD-së, pranon se ka dijeni të bindjeve politike të banorëve të qytetit dhe përligj pretendimin se largimi është bërë për shkaqe politike”.

- Mbështetur në nenin 33/8, të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës nr. 09, datë 10.02.2021, Komisioneri me shkresën nr. 286/4, datë 18.05.2021 njoftoi, Bashkinë Mat dhe ankuesin për zhvillimin e seancës dëgjimore me datë 28.05.2021, për të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtpërdrejtë pretendimet e tyre dhe për të sqaruar të gjitha faktet dhe provat e palëve në proces.

Seanca dëgjimore u zhvillua në mungesë të subjektit ankues dhe në prezencë të Bashkisë Mat, e cila u përfaqësua Drejtori i Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, G.P.

Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesi i Bashkisë Mat, i qëndroi të njëjtave parashtrime që kishte bërë të njohur gjatë komunikimit shkresor me KMD-në.

Në vijim, ankuesi me shkresën datë 22.07.2021, protokolluar me tonën, nr. 286/5, datë 26.07.2021, ka paraqitur pranë institucionit të Komisionerit një kërkesë për heqjen dorë nga shqyrtimi i ankesës dhe pushimin e saj.

Në nenin 90/3 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” parashikohet se: “Përfundimi i procedurës administrative:...3. Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”.

Në nenin 94/1 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” parashikohet se: “Tërheqja e kërkesës.....: 1. Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”.

Komisioneri konstaton se procedura administrative konkrete ka filluar mbi bazën e ankesës së paraqitur nga E.M, i cili me anë të kërkesës, datë 22.07.2021 është tërhequr nga ankesa.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri çmon se jemi në kushtet e nenit 90/3 dhe 94/1, të Kodit të Procedurave Administrative dhe për rrjedhojë procedura administrative për shqyrtimin e ankesës duhet të deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për shkak se ankuesi është tërhequr nga ankesa.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1 të Ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, nenin 32, pika 3, nenin 33, pika 10 të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 09, datë 10.02.2021, paraqitur nga E.M kundër Bashkisë Mat për shkak se ankuesi është tërhequr nga ankesa.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Robert GAJDA